

**VENDIM**  
**Nr. 202, datë 11.4.2018**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT**  
**TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË**  
**URBANE”, TRUALL, PËR SIPËRFAQET QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT TË**  
**RRUGËVE PËRGJATË BREGUT JUGOR TË REZERVUARIT TË MOGLICËS, TË**  
**PASURIVE ME NUMRAT 407/1, 408/2, 408/1 E 414, ZONA KADASTRALE 3971, DHE TË**  
**PASURIVE ME NUMRAT 422/1, 423/4, 423/1, 424, 117/1, 127, 113, 121/3, 111, 109, 23/2, 23/7, 30,**  
**31 E 86, ZONA KADASTRALE 2937, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të tokës, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për parcelat me sipërfaqe të përgjithshme 11 972 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>, pjesë e pasurive me numrat nr. 407/1, 408/2, 408/1 e 414, zona kadastrale 3971, dhe të pasurive me numrat 422/1, 423/4, 423/1, 424, 117/1, 127, 113, 121/3, 111, 109, 23/2, 23/7, 30, 31 e 86, zona kadastrale 2937, me vendndodhje në njësinë administrative Moglicë, Bashkia Maliq, Qarku Korçë, të cilat preken nga projekti hidroenergetik i Devollit, për ndërtimin e rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë pjesë përbërëse e tij.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Qarkun e Korçës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, respektivisht për secilën parcelë, për aq sa preket nga ndërtimi i rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës, parcelat me numrat e pasurive 407/1, 408/2, 408/1 e 414, zona kadastrale 3971, dhe me numrat e pasurive 422/1, 423/4, 423/1, 424, 117/1, 127, 113, 121/3, 111, 109, 23/2, 23/7, 30, 31 e 86, zona kadastrale 2937, me vendndodhje në njësinë administrative Moglicë, Bashkia Maliq, Qarku Korçë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Qarkun e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

Lidhja 1

| Nr. | Vepra                | Qarku | Zona<br>kadas. | Fshati  | Statusi i<br>pronës | Parcela<br>nr. | Përdorimi               | Sipërfaqe në kartelë<br>(m <sup>2</sup> ) | Zona e prekur<br>(m <sup>2</sup> ) |
|-----|----------------------|-------|----------------|---------|---------------------|----------------|-------------------------|-------------------------------------------|------------------------------------|
| 1   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 3971           | Kodras  | Shtet               | 407/1          | Pemëtore                | 955,386                                   | 667                                |
| 2   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 3971           | Kodras  | Shtet               | 408/2          | Toke bujqësore          | 4,963                                     | 480                                |
| 3   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 3971           | Kodras  | Shtet               | 408/1          | Toke bujqësore          | 8,458                                     | 605                                |
| 4   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 3971           | Kodras  | Shtet               | 414            | Toke bujqësore          | 21,207                                    | 563                                |
|     |                      |       |                |         |                     |                |                         |                                           |                                    |
| 1   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 422/1          | Toke bujqësore          | 16,923                                    | 738                                |
| 2   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 423/4          | Toke bujqësore          | 10,051                                    | 792                                |
| 3   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 423/1          | Toke bujqësore          | 3,534                                     | 77                                 |
| 4   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 424            | Toke bujqësore          | 6,856                                     | 50                                 |
| 5   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 117/1          | Toke bujqësore          | 22,425                                    | 269                                |
| 6   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 127            | Toke bujqësore          | 8,986                                     | 584                                |
| 7   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 113            | Toke bujqësore          | 20,035                                    | 523                                |
| 8   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 121/3          | Toke bujqësore          | 37,095                                    | 20                                 |
| 9   | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 111            | Toke bujqësore          | 159                                       | 36                                 |
| 10  | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 109            | Toke bujqësore          | 2,468                                     | 988                                |
| 11  | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 23/2           | Toke bujqësore          | 2,376                                     | 158                                |
| 12  | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 23/7           | Toke bujqësore          | 3,594                                     | 212                                |
| 13  | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 30             | Toke bujqësore          | 2,206                                     | 471                                |
| 14  | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 31             | Toke bujqësore          | 3,594                                     | 4,639                              |
| 15  | Rruga Peshtan–Kodras | Korçë | 2937           | Peshtan | Shtet               | 86             | Toke bujqësore          | 591                                       | 100                                |
|     |                      |       |                |         |                     |                | TOTAL (m <sup>2</sup> ) |                                           | 11,972.00                          |